

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit M. Z. nga ..., të cilin e përfaqëson P. P. avokat nga Gjakova, kundër të paditurës K. e S. "S." me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson B. M. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas revizioneve e paditësit dhe të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1746/2015 datë 25.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.11.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara revizionet e paditësit dhe të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1746/2015 datë 25.06.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.436/2012 datë 4 nëntor 2014, nën pikën I. të dispozitivit pjesërisht aprovet kërkesëpadia e paditësit M. Z. nga ..., dhe detyrohet e paditura K. e S. "S." me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 12 tetor 2011, t'i paguajë këto shuma : në emër të dëmit jo material për shkak të dhimbjeve fizike të përjetuara shumë prej 5.000 €, për

frikën e përjetuar shumë prej 4.500 €, për shëmtim trupor shumë prej 1.000 €, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë prej 4.000 €, Në emër të dëmit material për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumë prej 300 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 300 €, për rehabilitimin fizikal shumë prej 400 €, për shpenzimet e mjekimit shumë prej 200 €, e në shumë të përgjithshme prej 15.700 €, me normën e kamatës në lartësinë të cilën e paguajnë bankat me mjetet e afatizuara mbi 1 vit duke filluar nga data e ekspertimit 25 korrik 2014, e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit. Në pikën II. të dispozitivit refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumat e aprovuara dhe atë për dhimbje fizike në shumë prej 3.000 €, për frikë shumë prej 2.500 €, për ndihmë dhe përkuajdesin e huaj shumë prej 700 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 700 €, për shpenzime të shërimit shumë prej 1.800 €, dhe për shpenzimet për rehabilitim shumë prej 1.100 €, si e pabazuar. Në pikën III. të dispozitivit refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit që ka të bëjë me kamatën mbi lartësinë e gjykuar. Në pikën IV. të dispozitivit detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore të paguajë shumë prej 1.019 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1746/2015 datë 25.06.2018, nën pikën I. të dispozitivit refuzohet e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë dhe ankesa e të autorizuarit të paditësit M. Z. nga ..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.436/2012 datë 04.11.2014, në pikën I. të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit jo material dhe material dhe atë për shëmtimin trupor , zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor , ndihmën dhe përkuajdesin e huaj për ushqimin e përforcuar për rehabilitimin fizikal për shpenzime të mjekimit si dhe në pikën II. III. dhe IV. vërtetohet. Në pikën II. të dispozitivit aprovohet pjesërisht ankesa e të paditurës K. e S. “S.” me seli në Prishtinë dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.436/2012 datë 04.11.2014, në pikën I. të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit jo material dhe atë për dhimbjet e përjetuara fizike dhe për frikën e përjetuar dhe gjykohet si në vijim: detyrohet e paditura K. e S. “S..” me seli në Prishtinë që paditësit M. Z. ..., në emër të kompensimit të dëmit jo material të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 12.10.2011 t'i paguajë shumë e specifikuar dhe atë për dhimbjet fizike të përjetuara shumë prej 4.500 €, dhe për

frikën e përjetuar shumë prej 3.800 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë sa i përket shumave të gjykuara për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar refuzohet si e pabazuar. Nën pikën III. të dispozitivit pranohet pjesërisht ankesa e të paditurës K. e S. "S." me seli në Prishtinë ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.436/2012 datë 04.11.2014, në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kamatën dhe vendoset ashtu që detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për 1 vit duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 04.11.2014 e deri në pagesën definitive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizione kanë paraqitur:

-e paditura për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

-i autorizuari i paditësit për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore , aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike me propozim që aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovet në tërësi.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës aktgjykimit të goditur dhe pretendimeve në revizione në pajtim me nenin 215 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Revizionet e të paditurës dhe të autorizuarit të paditësit janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me datë 12.10.2011, në orën 07:45 minuta në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë në Fushë Kosovë, udhëkryq që shpije në drejtim të fshatit Uglar ka ndodhur aksidenti i komunikacionit. Shkaktar kryesor i këtij aksidenti është drejtuesi i automjetit "Vollcvagen" 351 Passat me targa ..., V. B., nga Prishtina i siguruari i të paditurës, gjer te aksidenti ka ardhur kur automjeti ishte në lëvizje dhe godet paditësin i cili ka qenë duke qarkulluar në shiritin për këmbësor dhe si pasojë e goditjes në këtë aksident paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore. Ndaj drejtuesit të automjetit është udhëhequr procedura penale dhe i njëjti është shpallur fajtor dhe është gjykuar sipas ligjit me aktgjykim të Gjykatës Themelore në

Prishtinë P.nr.2534/2012 datë 11.07.2013, i cili ka marr formën e prerë. Në procedurën penale është bërë edhe ekspertiza e komunikacionit nga ekspertja e komunikacionit L. K., nga mendimi i të cilës rezulton se shkaktar kryesor në aksident është vozitësi i automjetit dhe se paditësi nuk ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit.

Për masat dhe llojin e lëndimeve të paditësit gjykata i vërtetoi në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe mendimit të ekspertëve dr.A. Z. neuropsikiatër, dr.I. K. ortoped traumatolog. Sipas dokumentacionit mjekësor dhe mendimit të ekspertëve është konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime, plagë prerëse-shkyese e kokës regjioni okcipital majtas, thyerje e harkut të unazës qafore të parë, thyerje të trupit të unazës së dytë të kraharorit padisklotiv. Këto lëndime kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Për shkak të këtyre lëndimeve paditësi ka pësuar dhimbje fizike posaçërisht të rëndë një orë , intensitetit të rëndë dy javë, intensitetit të mesëm dy muaj, dhe intensitetit të ulët që janë prezentë edhe sot. Paditësi ka përjetuar frikë të intensitetit të lartë katër orë të intensitetit të mesëm tre muaj dhe të ulët dhjetë muaj. Zvogëlim i përhershëm i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është i shprehur në shkallë prej 13%. Si pasojë e aksidentit paditësi ka shëmtim trupor në shkallë të lehtë. Përkujdesja e personit tjetër ka qenë e nevojshme për dy javë dhe ushqim të përforcuar dy muaj. Rehabilitim fizioterapeutik klimatik ka qenë i nevojshëm dy herë nga dy javë.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike pjesërisht e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar ashtu siç është vendosur nën pikat e aprovuara të dispozitivit të aktgjykimit duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit mbi shumat e aprovuara.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore pjesërisht ka pranuar ankesën e të paditurës dhe ka vendosur më afërsisht të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të goditur.

Për sa i përket shumave të gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë përkitazi me dëmin jo material dhe material për paditësin drejt janë aplikuar dispozitat e nenit 195, 200 dhe 201 të LMD lidhur me nenin 323 të LPK, duke pasur parasysh konstatimet dhe mendimet e ekspertëve mjekësor lëndime të pësuar, natyrën, peshën , intensitetin e dhimbjeve të paditësit etj. Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jo material (si një satisfacion që nuk ka qëllim lukrativ-fitim prurës) përfaqëson zbatimin e së drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit

për format e caktuara të dëmit jo material dhe të frikës si lloj i mvetsishëm i dëmit jo material gjykata sipas nenit 200 të LMD, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim por edhe për çështjen që të mos favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimit pasuror. Prandaj, duke pasur parasysh këto kritere të parapara me dispozitën e lartcekur shumat e caktuara nga gjykata përkitazi me llojet e sipër cekura të dëmit jo material dhe ato material (nga gjykata e shkallës së dytë), sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë reale në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore. Nga lart të cekurat pretendimet e palës paditëse në revizion lidhur me lartësinë e shumave të gjykuara kjo gjykatë i vlerëson si të pathemelta.

Po ashtu është i pabazuar pretendimi në revizion se gjykatat e instancës më të ulët kanë qenë dashtë që paditësit të gjykojnë kamatën në lartësi prej 12%, siç parashihet me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Kjo për arsye se është fakt se me nenin 26 pika 6 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm është përcaktuar norma e interesit në lartësi prej 12%. Mirëpo kjo dispozitë aplikohet në ato raste kur kompanisë e sigurimeve i është parashtruar kërkesa për kompensimin e dëmit dhe ajo nuk e rregullon atë dëm brenda afatit të caktuar. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura ka dhënë ofertën për rregullimin e dëmit por pala paditëse nuk është pajtuar me ofertë për çfarë arsye është iniciuar procedura kontestimore. Përkatësisht pala paditëse nuk ka ofruar në tërësi provat se e paditura kur është përgjigj në kërkesë të paditësit për rregullim të dëmit a ka vepruar në kuptim të dispozitave të nenit 26 të Ligjit për sigurim të detyrueshëm e që është para kusht për aplikimin e kamatës në lartësi prej 12%. Prandaj pretendimet e paditësit në këtë drejtim paraqiten si të pabazuara.

Nga sa u tha më lart e në bazë të nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.373/2018 datë 20.11.2018

Kryetar i kolegjit,

Isa Kelmendi

